

Temat e Thelluar, Seanca 8

HOMOSEKSUALITETI

Çfarë beson shoqëria për homoseksualitetin

Informacioni që vijon është marrë nga materialet e siguruar nga Fondi Lambda i Mbrojtjes Legale dhe Edukimit. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për ardhmen që ka bota sot përkundrejt homoseksualitetit dhe gjithashtu për prirjen e propozimeve të saj për trajtimin e kësaj dukurie:

Termet:

Lesbige është një femër, e cila tërhiqet seksualisht, si nga ana afektive ashtu dhe ajo fizike, kryesisht ndaj femrave të tjera.

Gej (Gay) i thuhet një personi, i cili tërhiqet seksualisht, si nga ana afektive ashtu dhe ajo fizike, kryesisht ndaj personave të të njëjtit seks. Shpesh, *gay* nënkupton posaçërisht një mashkull, që tërhiqet pas meshkujve të tjerë.

Biseksual është personi që tërheqet seksualisht, si nga ana afektive ashtu dhe ajo fizike, si ndaj femrave ashtu edhe ndaj meshkujve, megjithëse jodomosdoshmërisht në të njëjtën kohë.

Identiti i Seksual është ndjesia e dikujt e të qenit si mashkull ose femër. *Identiteti i seksual* i një personi mund të mos jetë i njëjti me seksin e tij biologjik të lindjes.

Transeksual është një term çadër për njerëz me paraqitje, karakteristika ose ndjenja të indentitetit gjinor të ndryshme nga tiparet tradicionale seksuale, pavarësisht orientimit seksual. Disa transeksualë kanë ndjekur ose planifikuar të ndjekin trajtime mjeksore për ta përqasur trupin me indentitetin e tyre seksual; të tjerë mund të mos zgjedhin të ndjekin trajtime të tilla.

Një person në dyshim është dikush që e merr më sy mundësinë se mund të jetë lesbige, gej, biseksual apo transeksual.

• **ÇFARË MËSON BIBLA PËR HOMOSEKSUALITETIN?**

- Bibla paraqet **qëllimin** e Zotit për seksualitetin njerëzor.
 - Perëndia i krijoi qëniet njerëzore si **mashkull dhe femër** (Zan 1:27).
 - Perëndia themeloi martesën për **burrin dhe gruan** (Zan 2:18, 24).
 - Atë që Zoti e krijon, Satani përpiqet ta **prishë** (Rom 1:18ff.).

- Bibla **përball** mëkatit seksual, përfshi homoseksualitetin.

Zanafilla 19:5-8, “thirrën Lotin dhe i thanë: "Ku janë njerëzit që erdhën te ti sonte? Na i nxirr jashtë që të mund t'i njohim!" Loti doli drejt tyre para portës së shtëpisë, e mbylli portën pas tij dhe tha: "Oh, vëllezër të mi, mos u sillni kaq keq! Dëgjoni, unë kam dy vajza që nuk kanë njohur burrë; prandaj, më lini që t'i nxjerr jashtë dhe bëni ç'të doni me to; por mos u bëni asgjë këtyre burrave, sepse janë nën mbrojtjen e shtëpisë sime.”

Eksodi 22:19, “Kush çiftëzohet me një kafshë do të dënohet me vdekje.”

Levitiku 18:22-23, “Nuk do të kesh marrëdhënie seksuale me një burrë, ashtu si bëhet me një grua; është një gjë e neveritshme. Nuk do të bashkohesh me asnjë kafshë duke u ndotur me të; gjithashtu asnjë grua të mos i afrohet një kafshe për t'u bashkuar me të; është një degjenerim i neveritshëm.”

Levitiku 20:13, “Në qoftë se dikush ka marrëdhënie seksuale me një burrë ashtu si ato që bëhen me një grua, që të dy kanë kryer një degjenerim të neveritshëm, do të dënohen pa tjetër me vdekje; gjaku i tyre do të bjerë mbi ta.”

Levitiku 20:15-16, “Në rast se një burrë bashkohet me një kafshë, ai do të dënohet me vdekje; do të vritet edhe kafsha. Në rast se një grua i afrohet një kafshe për t'u bashkuar me të, do të vrasësh gruan dhe kafshën; do të dënohen pa tjetër me vdekje; gjaku i tyre do të bjerë mbi ta.”

Ligj. Për. 23:17, “Nuk do të ketë asnjë grua që të merret me kurvëri midis bijave të Izraelit, nuk do të ketë asnjë burrë që të merret me kurvëri midis bijve të Izraelit.”

Ligj. Për. 27:21, “Mallkuar qoftë ai që bie në shtrat me çfarëdo kafshë!". Dhe tërë populli do të thotë: "Amen!”

Gjyqt. 19:22, “Ndërsa po kënaqeshin, disa njerëz të qytetit, njerëz të këqij rrethuan shtëpinë i ranë portës dhe i thanë të zotit plak të shtëpisë: "Nxirre jashtë atë njeri që ka hyrë në shtëpinë tënde, sepse duam ta njohim!”

1 Mbret. 14:24, “Përveç kësaj, kishte në vend njerëz që jepeshin mbas kurvërisë së shenjtë. Ata merreshin me të gjitha gjërat e neveritshme të kombeve që Zoti kishte dëbuar përpara bijve të Izraelit.”

1 Mbret. 15:12, “Eliminoi nga vendi ata që merreshin me kurvëri të shenjtë dhe tërë idhujt e krijuar nga etërit e tij.”

1 Mbret. 22:46, “Ai zhduku nga vendi mbeturinat e atyre që merreshin me kurvëri dhe që kishin mbetur nga koha e Asas, atit të tij.”

2 Mbret. 23:7, “Shembi edhe shtëpitë e njerëzve që merreshin me kurvërinë e shenjtë dhe që ndodheshin në shtëpinë e Zotit, ku gratë endnin çadra për

Asherahun.”

Romakëve 1:24 “Prandaj, Perëndia ia dorëzoi papastërtisë në epshet e zemrave të tyre, për të çnderuar trupat e tyre në mes vetë atyre.”

Romakëve 1:26, “Prandaj, Perëndia i dorëzoi ata në pasione të ulëta, sepse edhe gratë e tyre i shndërruan marrëdhëniet natyrore në atë që është kundër natyrës.”

Romakëve 1:27, “Në të njëjtën mënyrë burrat, duke lënë marrëdhëniet e natyrshme me gruan, u ndezën në epshin e tyre për njëri-tjetrin, duke kryer akte të pandershme burra me burra, duke marrë në vetvete shpagimin e duhur për gabimin e tyre.”

1 Korintasve 6:9, “A nuk e dini ju se të padrejtët nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë? Mos u gënjeni: as kurvarët, as idhujtarët, as shkelësit e kurorës, as të zhburrëruarit, as homoseksualët.”

1 Timoteut 1:9-10, “Duke ditur këtë, që ligji nuk është vënë për të drejtin, po për të pabesët dhe rebelët, për të ligët dhe mëkatarët, për të pamëshirshmit dhe të ndyrët, për ata që vrasin babë e nënë, për vrasësit, për kurvarët, për homoseksualët, për grabitësit, për rremët, për ata që shkelin betimin, për çdo gjë tjetër që bie në kundërshtim me doktrinën e shëndoshë.”

- **CILA ËSHTË PËRGJIGJA TIPIKE E HOMOSEKSUALËVE PËR ATË QË BIBLA MËSON?**

- Familjarizohu me “**hermeneutikën homoseksuale**.”
 - “Hermeneutika homoseksuale” thotë që Bibla nuk flet në asnjë vend për homoseksualitetin “**natural**” sikurse e kemi ne sot.
 - Ajo, gjithashtu, thotë se ajo që kanë nevojë të bëjnë homoseksualët është e njëjta gjë që edhe ata në një marrëdhënie **heteroseksuale** kanë nevojë të bëjnë, që është të praktikojnë sjellje seksuale vetëm brenda një marrëdhënie dashurie të **përkushtuar**.
- Familjarizohu me **argumentet** e zakonshme.
 - Homoseksualiteti është një orientim **i dhënë nga Zoti**.
 - Homoseksualiteti është një orientim **biologjik**.
 - Ka prova për një “**gen gay**.”

Për shembull, Simon LaVay bëri ekzaminime pa-vdekjes në trurin e 19

burrave homoseksualë, që vdiqën nga SIDA dhe 16 burrave të supozuar heteroseksualë, 6 nga të cilët vdiqën nga SIDA. Rezultatet e tij sugjerojnë se truri i burrave heteroseksualë vazhdimisht kishte më shumë qeliza truri në një zone të caktuar të trurit (INAH 3), që gjoja ndikon në sjelljen seksuale.

- **SI TA NDIHMOJMË HOMOSEKSUALIN?**

- Ne duhet ta ndihmojmë atë **të pranojë** atë çka Bibla thotë për homoseksualitetin.
 - Duhet të përdorim Shkrimet.
 - 1 Korintasve 6:9-10
 - Juda 7
 - Romakët 1
 - Duhet t'i flasim për **mitin** që homoseksualiteti është një gjendje "gjenetike".
- Duhet ta ndihmojmë atë të shohë se Krishti është i **mjaftueshëm për të** që të bëjë ndryshimin.
 - Nëse personi nuk është besimtar, ne duhet t'i tregojmë që ndryshimi është i **mundur** vetëm për ata që njohin Krishtin.
 - Nëse personi është besimtar ne duhet t'i tregojmë që ndryshimi i **kërkohe**t, sepse ai e njeh Krishtin. (Shih 2 Pjetrit 1:5-11)
- Ne duhet ta nxëmë dhe të zbatojmë parimin e **prerjes rrënjësore të gjymtyrëve (amputimit)** (Mateu 5:29-30).
- Ne duhet të theksojmë nevojën për të **rindërtuar** tërësisht jetën e tij. Kjo përfshin:
 - **Mendimet e tij.**
 - **Marëdhëniet e tij.**
 - **Orarin e tij.**
- Ne mund të na duhet të kërkojmë vëmendje **mjekësore**.